



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:009504
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05872744

C.nr.10569/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: 1.F. K., nga fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës dhe 2.S. B., nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson R. M., avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë, jashtë seancës gjyqësore, më datë 28.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F. K., nga fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës dhe S. B., nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që:
 - Paditësit S. B., në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, të ia kompensojë një pagë bazë në shumën prej 459.00 € (katërqind e pesëdhjetë e nëntë euro) me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë (datë 28.12.2023), deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës, që paditëses F. K., në emër të shpenzimeve të udhëtimit (transportit) për ditët e pranisë në punë, për 696 ditë të punës, për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më datë 31.07.2020, t'ia kompensojë shumën prej 682.08 € (gjashtëqind e tetëdhjetë e dy euro e tetë cent).
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 186.00 € (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro), brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit F. K., dhe S. B., përmes përfaqësuesit të autorizuar, pranë kësaj Gjykate, më datën 28.12.2023, kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë. Në padi, ndër tjera theksohet se paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës, si mësimdhënës në SH.M.L.E.J “H. K. P.”, në Prishtinë dhe atë në vendin e punës profesor i lëndëve juridike, respektivisht mësimdhënës i matematikës. Tutje, ka theksuar se me nenin 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë kompensimi shpenzimeve të udhëtimit se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë shpenzimet e rrugës 70% te biletave të trafikut urban”*. Po ashtu, ka theksuar se në bazë të nenit 35 par.8 pika 8.3 të kësaj Kontrate është parapare se *“punëtoret për vitet jubilarë përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë të një page”*. Andaj, mbi bazën e këtyre pretendimeve, e në kuptim të nenit 35 paragrafi 5 dhe 8 të Kontratës Kolektive si dhe nenit 90 të Ligjit të Punës, në petitim të kërkesëpadisë është propozuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësve dhe të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditëses F. K., në emër të shpenzimeve të udhëtimit (transportit) për ditët e pranisë në punë, t’ia kompensojë shumën prej 682.08 €, për 696 ditë të punës, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 31.07.2020, ndërsa paditësit S. B., në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t’ia kompensojë një pagë bazë në shumën prej 459.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar dhe i kanë specifikuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 16.04.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me pretendimin se kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, duke shtuar tutje se e paditura, gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Po ashtu në rastin konkret ekziston edhe parashkrimi i kërkesës pasi konform dispozitave të Ligjit të Punës të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritore në kuptim të dispozitave nga neni 398 dhe 399 të LPK-së. Nga përmbajta e këtyre dispozitave ligjore, Gjykata gjeti se për vendosje meritorë pa mbajtjen e seancës gjyqësore, kërkohet që gjendja faktike të mos jetë kontestuese për vetë gjykatën, pavarësisht kontestimit të fakteve vendimtare nga ana e palëve në procedurë. Në këtë kuptim, meqenëse nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, për gjykatën nuk ekziston asnjë fakt kontestues, dhe nuk ekziston asnjë pengesë tjetër për dhënien e vendimit meritore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësit F. K., dhe S. B., janë në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht janë të punësuar në institucionin arsimor SH.M.L.E.J “H. K. P.,” në Prishtinë.

Paditësja F. K., është e sistemuar në pozitën profesoreshë e lëndëve juridike, çka vërtetohet sipas Kontratës së punës me numër të protokollit 18, e datës 01.09.1980. Nga, Vërtetimi me numër protokollit 407/I, të datës 21.12.2023, të lëshuar nga institucioni ku është e punësuar paditësja vërtetohet se e njëjta, brenda periudhës nga data 18.04.2017 deri më datë 31.07.2020 ka realizuar gjithsej 696 ditë pune. Nga Certifikata e vendbanimit B 10511055, lëshuar më datë 21.12.2023 vërtetohet se paditësja ka adresë të vendbanimit në Fshatin Miradi e Epërme, Komuna Fushë Kosovë. Ndërkaq, nga biletat e autobusit, bashkëngjitur në formë të kuponit fiskal, u vërtetua se paditësja në relacionin shtëpi – vend i punës dhe anasjelltas, shpenzon gjithsej 1.40 € në përditshmëri.

Ndërkaq, paditësi S. B., është i punësuar si mësimdhënës në lëndën e matematikës, rrethanë kjo e cila vërtetohet sipas Kontratës së punës me numër të protokollit 156, e datës 12.09.2013. Sipas Vërtetimit me numër protokollit 414/I, të datës 22.12.2023, të lëshuar nga institucioni ku është i punësuar paditësi, vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune prej 32 vite, 3 muaj e 21 ditë. Ndërsa, në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, të bashkëngjitur me shkresat e lëndës, u vërtetua se paditësi realizon pagë bazë në vlerë prej 459.00 €. Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, respektivisht me datë 22.01.2021.

Sa i përket vendosjes si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata iu referua pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës, ku në mënyrë specifike nga vërtetimi me numër protokollit 414/I, i datës 22.12.2023 lëshuar nga SH.M.L.E.J “H. K. P., ka vërtetuar faktin se paditësi S. B., ka përvojë pune prej 32 vite 3 muaj dhe 21 ditë. Bazuar në një përlllogaritje të thjeshtë, rezulton se paditësi, vitin jubilar të punësimit për 30 vite të përvojës së punës e ka arritur në muajin shtator të vitit kalendarik 2021. Andaj, duke qenë se paditësit i ka lindur e drejta e kompensimit të shpërblimit jubilar, pikërisht në muajin shtator të vitit 2021, kjo Gjykatë vlerëson se kërkesëpadija e paditësit lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar gjenë mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpërblimit jubilar, parashihet me dispozitën nga neni 35 par.8 të Kontratës Kolektive të lartcekur, ku është përcaktuar se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë:*

8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50% të një page bazë; 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë; 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësi është i legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Referuar dispozitave të lartcekura, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit Sahit Bajraktari, lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, është e bazuar. Mbi këtë bazë, përlllogaritja është bërë duke u bazuar në pagën bazë të cilën e realizon paditësi. Kështu, nga provat e bashkëngjitura u vërtetua se i njëjti realizon pagë bazë në vlerë prej 459.00 €, andaj konform dispozitës së lartcekur, rezulton se paditësit, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, i takon shuma prej 459.00 €.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke vlerësuar pretendimet e të paditurës Komuna e Prishtinës lidhur me atë se kërkesëpadia e paditësve përmban kërkesa të parashkruara. Këtë pretendim të palës së paditur, Gjykata e gjeti të bazuar përkitazi me kërkesëpadinë e paditësës F. K., për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit, dhe atë duke pasur parasysh nenin 87 të Ligjit të Punës ku përcaktohet se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.” Kërkesat nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, përfshijnë periudhën nga data 18.04.2017 e deri më datë 31.07.2020, ndërkaq padia e paditësve është dorëzuar në Gjykatë më datë 28.12.2023, pra pasi që ka arritur parashkrimi i kërkesave për periudhën e kërkuar. Në këtë kuptim, Gjykata e refuzoi kërkesën për kompensim në emër të shpenzimeve të transportit, për 696 ditë pune, në shumë prej 682.08 €, si të pa bazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet tjera të ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në dy rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, si dhe lidhur me faktin se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditësve për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: “Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe

përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur”. Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e kësaj Kontrate, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lart cekur, në njërin anë janë paraparë të drejta për njërin palë, e në anën tjetër janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditësve për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësit t'i realizojnë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, ta paguajë së bashku me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila kamatë do të fillojë të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatës, e deri në pagesën definitive të shumës si në pikën I të dispozitivit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika III e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 453, 452 par.1 e lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësve t'ua kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 186.00 € dhe atë: 156.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 30.00 € në emër të taksës për padi. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Bazuar në të lartë cekurat, në bazë të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.10569/2023, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët.